



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM

Nr.13, datë 3.2.2016

“PËR

**MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË
RREGULLOREN “PËR LICENCIMIN, RREGULLIMIN DHE MBIKËQYRJEN E OPERATORËVE
TË SKEMAVE KOMBËTARE TË PAGESAVE ME KARTË ”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “c”, si dhe nenit 53, pika 4 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe me propozimin e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë dhe të Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren: “Për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve të skemave kombëtare të pagesave me kartë”, miratuar me vendimin nr. 42, datë 26.06.2013 të Këshillit Mbikëqyrës, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Në nenin 9, pika 3 togfjalëshi “*Guvernatori i Bankës*” zëvendësohet me togfjalëshin “*Zëvendësguvernatori i Parë i Bankës*”.
 - b) Në nenin 17, pika 3 togfjalëshi “*Zëvendësguvernatori i Parë i Bankës*” zëvendësohet me togfjalëshin “*Drejtori i DSPKF i Bankës*”.
 - c) Në nenin 30, pika 4 togfjalëshi “*Guvernatori i Bankës*” zëvendësohet me togfjalëshin “*Zëvendësguvernatori i Parë i Bankës*”.
2. Në të gjithë përmbajtjen e rregullores togfjalëshi: “Departamenti i Sistemeve të Pagesave”, zëvendësohet me togfjalëshin: “*Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës*”.

3. Ngarkohet Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës me zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

SEKRETARI

KRYETARI

Elvis Çibuku

Gent Sejko